

VENDIM
Nr.264, datë 22.6.1992

PËR OBJEKTET QË SIGUROHEN ME ROJE CIVILE TË ARMATOSURA

Në zbatim të shkronjës "a" të nenit 7 të ligjit nr.7566, datë 25.5.1992 "Për armët", Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Të pajisen me armë zjarri të gjata rojet civile që sigurojnë objektet e mëposhtme:
 - a) Depot e ujit të pijshëm, të lëndëve plasëse, helmuese me efekte të forta, lëndëve radioaktive.
 - b) Nënstacionet elektrike, stacionet hekurudhore, të përpunimit të mallrave, depot qendrore të karburanteve dhe ato të lëndëve djegëse.
 - c) Depot e rezervave të Shtetit dhe ato ku ruhen ndihmat e tjera shtetërore e humanitare.
 - ç) Ndërmarrje, institucione dhe objekte të tjera shtetërore dhe private, ku prodhohen, përpunohen e administrohen mallra me vlera të konsiderueshme ose kanë aktivitet tjetër të rëndësishëm ekonomik e social.
 2. Përcaktimi i objekteve sipas shkronjës "ç" të pikës 1 të këtij vendimi bëhet nga drejtuesit e organeve të pushtetit lokal në rrethe në marrëveshje me Degën e Rendit Publik.
 3. Për sigurimin e objekteve sipas këtij vendimi, të zbatohen dispozitat e ligjit nr.7566, datë 25.5.1992. "Për armët".
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi